



BASHKIA MIRDITË

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar se janë hapur procedurat e aplikimit për programin;
Subvencionim i Bonusit të Qirasë nga periudha Janar – Dhjetor për vitin 2024.

Objekti dhe qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat administrative të shpërndarjes së programeve sociale për strehim, me qëllim krijimin e mundësive për strehim dhe në ndihmë të institucioneve shtetërore përgjegjëse

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.

Individi/familja nuk mund të përfitojë njëkohësisht më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë.

Rregullat e subvencionimit të qirasë

Aplikimi i individit/familjes për të përfituar subvencionimin e qirasë do të bëhet pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore, lista e përfituesve për subvencionim miratohet nga Këshilli i Njesisë së Veteqeverisjes Vendore. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht apo plotësisht nga qeverisja qendrore lista e përfituesve miratohet nga Bashkia më pas i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehim.

Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë këto kategori:

- Individët me statusin e jetimit
- Personat me aftësi të kufizuar
- Invalidët e punës
- Familjet e policëve të rënë në detyrë
- Emigratët e rikthyer
- Puntor emigrant
- Azilkërkuesit
- Familjet e komunitetit rom
- Familjet e komunitetit egjiptian
- Viktimat e dhunës në familje
- Viktimat e trafikimit

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- Prindërit e vetëm që kanë në ngarkim fëmijet
- Individët që i përkasin komunitetit LGBT
- Të mitur 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në konflikt me ligjin
- Vajzat nëna pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara
- Të mitur 14-18 vjeç dhe të rinjtë 18-21 vjeç në konflikt me ligjin
- Vajzat nëna pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara

Në bazë të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 9 “Parimi i transparencës dhe i informimit të publikut” organet e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë informacion të plotë , të lehtë për t’u gjetur dhe të kuptueshëm për çdo individ apo familje përsa i përket programeve sociale të strehimit.

Sipas nenit 13 të këtij ligji:

Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:
- c) i fatkeqësive natyrore;
- d) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;
- e) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;
- f) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- g) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”.

Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

- h) Të drejtën për të përfituar nga programi i banesave sociale të specializuara e kanë edhe të miturit nën moshën 18 vjeç, pas lirimit ose përfundimit të programit të masës alternative të shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë, për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre.

Dokumentacioni “Për strehimin social”:

- certifikatë familjare;
- vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.
- Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018,
- vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;
- vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI“, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
- dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuar;
- dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;
- urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;
- vetëdeklarim nëse individ/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
- dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- vërtetim me certifikatë familjare se individ i përket kategorisë vajzë-nënë.

Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës “ç”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”:

- vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t’i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- Vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

Shënim: Çdo aplikant duhet të kryejë gjithashtu edhe aplikimin në [e-Albania](#).

Kërkesë për të përfitur nga programet e strehimit social

***Afati i Aplikimeve deri me 25 Dhjetor 2024**

Për çdo informacion të mëtejshëm jeni të lutur të drejtoheni pranë zyrave të bashkisë Mirditë

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI“, RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

[email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al](mailto:bashkia@bashkiamirdite.gov.al)

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al